



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS

R A P O R T

Dhjetor 2022

Raport Muji

PËRMBAJTJA

Lënda

Faqe

Përmbajtja

I. Statistika

(3 - 5)

1. Numri i personave të dënuar me dënime alternative të dhëna nga gjykata për muajin Dhjetor 2022,
2. Numri i personave të dënuar me dënime alternative për të cilët ka përfunduar periudha e provës, për të cilët është dhënë vendimi i pushimit nga prokuroritë për muajin Dhjetor 2022,
3. Numri gjithsej i personave të dënuar me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës,
4. Numri mesatar i personave të dënuar me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe degë territoriale,
5. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

II. Bashkëpunimi me partnerët

(5)

- Me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, gjykatat, prokuroritë dhe organet e pushtetit qendror e vendor,
- Me OJF-të.

III. Problematikat e punës

(5 -6)

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 8, pika 1 germa b), të Ligjit nr. 78/2020 “Për “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës”, po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Dhjetor 2022.

Bazuar në urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës” i ndryshuar. Shërbimi i Provës ka **22** Zyra Vendore me vendndodhje në qytetet Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Berat, Mat, Kukës, Vlorë, Krujë, Lushnjë, Dibër, Kavajë, Kurbin, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë dhe Tropojë.

I. Statistika

Për muajin Dhjetor 2022, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka ardhur në rritje, numri i të dënuarve me dënime alternative që specialistët mbikëqyrin, kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

1.Gjithsej persona të dënuar me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për periudhën (01.12.2022 – 31.12.2022).

Gjatë muajit Dhjetor 2022, kanë ardhur pranë Degëve Territoriale **673** urdhra ekzekutimi nga prokuroritë, që do të thotë se ngarkesës aktuale të mbikëqyrjes do ti shtohen dhe **673** persona të dënuar. Këto të dhëna jepen si më poshtë:

Persona të dënuar shtesë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën (01.12.2022 – 31.12.2022).

Tabela 1.

Lloji i dënimeve alternative	Gjithsej
Neni 59 i KP, Pezullimi	521
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	6
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	18
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	128
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0
Gjithsej	673

Persona të dënuar për të cilët ka përfunduar koha e provës për periudhën (01.12.2022 – 31.12.2022).

Tabela 2.

Lloji i dënimeve alternative	Gjithsej
Neni 59 i KP, Pezullimi	612
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	3
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	13
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	156
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0
Gjithsej	784

2. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 01.12.2022 – 31.12.2022).

Gjithsej persona të dënuar me një prej dënimeve alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës është **10552**.

Sipas llojeve të dënimeve alternative, ky informacion jepet si më poshtë:

Tabela 3.

Lloji i dënimeve alternative	Gjithsej nën mbikëqyrje 31.12.2022
Neni 59 i KP, Pezullimi	9378
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	99
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	361
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	709
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	5
Gjithsej	10552

4. Gjithsej të dënuar me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe Degë Territoriale.

Sa më sipër duke ju referuar numrit gjithësej të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **10552** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **114**. E shprehur kjo për çdo degë territoriale është si më poshtë:

Tabela 4.

DEGËT TERRITORIALE	Gjithsej nën mbikëqyrje	Numri i Specialisteve	Të mbikëqyrrur për specialist
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tiranë	3065	21	146
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Durrës	525	5	105
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Fier	1058	3	353
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Shkodër	1096	8	137
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Lezhë	224	5	45
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Elbasan	541	3	180
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Korçë	378	2	189
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Gjirokastrë	206	1	206
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Mat	64	1	64
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Vlorë	847	3	282
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Berat	620	3	207
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kukës	203	2	101
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Pogradec	161	1	161
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Lushnje	447	2	223
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kurbin	283	1	283
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Krujë	268	1	268
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Pukë	32	1	32

Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Sarandë	197	1	197
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kavajë	129	1	129
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Dibër	105	1	105
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tropojë	70	1	70
Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Përmet	33	1	33
Gjithsej	10552	68	155

5. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për muajin Dhjetor 2022:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **27** raporte vlerësimi për persona të pandehur;
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **35** raporte vlerësimi për persona nën hetim ;
- ❖ Kanë ardhur **673** urdhra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 7 urdhra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **784** persona të dënuar me dënime alternative .

II. Bashkëpunimi me partnerët.

- Me partnerët.

Ecuria e bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me partnerët si: Policia e Shtetit, gjykatat, prokuroritë dhe pushtetin vendor ka qenë në vazhdimësi në përputhje me qëllimin e bashkëpunimit.

- Me OJF-të

Gjatë muajit Dhjetor 2022 ka vazhduar normalisht bashkëpunimi i degëve territoriale me OJF-të, sipas marrëveshjeve që janë nënshkruar lidhur me trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative, por në disa degë ka nevojë për përmirësim, lidhur me mungesën e një organizate që ndihmon në trajtimin dhe rehabilitimin e të dënuarve të cilët kanë varësi nga drogat ose alkoli.

III. Problematika e punës.

- Adresat të pasakta nga gjykatat dhe prokuroritë, të cilat nuk bëjnë të mundur njoftimin e të dënuarit për t'u paraqitur pranë Degëve Territoriale.
- Mangësi të shfaqura në vendimin e gjykatës (pengesa në fillimin dhe vazhdimin e procedurave),
- Mos kthimi i përgjigjeve të kërkesave drejtuar Prokurorive , duke përfshirë kërkesat për informacion, raportet e mospërbushjes, raportet përfundimtare duke sjelle në këtë mënyrë vështirësi në zbatimin e detyrave funksionale.
- Shërbimi postar sjell vonesa në kthimin e korrespondencave brenda afateve kohore.
- Mungesa e Burimeve Njerëzore (kapaciteteve) në disa Degë Territoriale

- Mungesa e një ambjenti funksional, në disa Degë Territoriale
- Trajnimet e pamjaftueshme (Ndërtimi i kapaciteteve)
- Mungesa e qendrave për trajtimin e personave të dënuarve varësi nga lëndët narkotike, drogërat e forta ose alkoli
- Mungesa e qendrave për trajtimin psikologjik të dhunës në familje.
- Mungesa e infrastrukturës për trajtimin psikologjik të të miturve në konflikt me ligjin dhe familjarëve të tyre,
- Rritja e nivelit të pagës,
- Nevojë imedjate për ristrukturim.

Duke shprehur se analiza e punës së kryer nga Shërbimi i Provës si dhe problematikat e hasura janë pasqyruar me objektivitet, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ervin Hoxha

